



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Nr. 512 REGJ.THEM

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e përbërë nga

GJYQTAR: ARTAN GJERMËNI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Ornela BALLA, sot më datë 16.07.2020 me prezencën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurore Suela Salavaci, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kërkesën penale me Nr. 512 Akti, që i përket:

KËRKUES: G.. R.. -i biri i N.. dhe i S.., i datëlindjes 23.12.19.., lindur dhe banues ne Tirane, me adrese :rruga "...", pall. nr..., shk..., ap. nr.. , me arsim te mesem, me gjendje gjyqësore i padënuar me pare, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, mbrojtur nga avokati i zgjedhur Ardian Leka - me nr.444 licence dhe Nipt K1614166P, Anetare i Dhomes se Avokatise Tirane .

OBJEKTI : Kthimin e dokumentave të sekuestruara.

BAZA LIGJORE : Neni 208,217,2018 e vijues të K.Pr.Penale.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata, pasi administroi provat shkresore, dëgjoji kërkuesin dhe av. Ardian Leka të cilët kërkuan pranimin e kërkeses dhe prokuroren Suela Salavaci që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi G.. R.. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë me objekt: "Kthimin e dokumentave të sekuestruara".

Rezulton se :Me vendimin gjyqësor Nr.2799 datë 25.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tirane është vendosur ndër të tjera “..

.....-Deklarimin e heqjes se mases se sigurimit pasuror “Sekuestros preventive” dhene me vendimin Nr.2293 Akti, date 13.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

-Urdherohet oficeri i Policise Gjyqesore per ekzekutimin e këtij vendimi.

-Shpenzimet procedurale hetimore e gjyqesore, ne ngarkim te prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

-Kundër vendimit mund të behet ankim nga palet brenda 15(pesembedhjetë) diteve ne Gjykaten e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes se këtij vendimi.Viktimat dhe perfaqesuesi i tyre nuk kane te drejten e ankimit....””

Sipas procesverbalit të sekuestrimit, nga ana e organit procedues më datë 16.05.2016 janë sekuestruar dokumentat sipas listimit të caktuar për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të datës 23.03.2016 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave.

Në vendimin gjyqësor penal Nr.2799 datë 25.10.2018, gjykata nuk është shprehur për kthimin e dokumentave të sekuestruara me procesverbal datë 16.05.2016 për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të datës 23.03.2016 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, referuar nenit 218 të K.Pr.Penale .

Pretendimi i kërkuesit për kthimin e e dokumentave të sekuestruara me procesverbal datë 16.05.2016 për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të datës 23.03.2016 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave,,gjykata cmon se kjo kërkese e paraqitur është e drejte dhe duhet të pranohet .

Me anë të procesverbalit për sekuestrimin e dokumentave datë 16.05.2016 është vendosur ndër të tjera që dokumentat që do të sekuestrohen janë dokumentat që ndodhen në dosjen Nr... datë 30.08.1994 në emër të N.. R.. të përshkruara si më poshtë.

Dy vendime në orgjinal me Nr.... datë 17.12.1995 dhe harta e vendimit.

Mandat arkëtimi nr... datë 24.08.1994.

Fletë inventari e datës 30.08.1994.

Vendim gjykate Nr....5 datë 30.05.1995.

Kërkesë drejtuar KKP nga trashigimtarët e N.. R...

8 Fletë shënimesh.

Vertëtim Arkivit Bashkia Tiranë me nr.... datë 28.09.1993.

Plan vendosje e vendimit në letër kalk.

Vertëtim pronësie e hipotekës e datës 13.11.1993.

Fotokopje e vendimit nr.... datë 17.12.1995.

Dy plane rilevimi për pronën e N.. R.. nxjerrë nga Bashkia Tiranë e datës 20.10.1993.

Fotokopje te vendimit të gjykatës Nr.... datë 30.05.1995.

Fotokopje e vendimit nr.... datë 19.11.1947.

Dy plan vendosje të pronës në emër të N..R...

Tre fotokopje të planvendosjes së pronës në emër të N.. R...

Dëshmi trashigimie Nr.... datë 09.01.1993 e Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Procesverbal i datës 03.11.1995 mbi verifikimin e pronës truall të shtetasit N.. R.. të mbajtur nga ing. Emil Nova dhe topogjeodet Abdulla Parllaku.

Sipas nenit 190 të K.r.Penale rezulton se:”Disponimi për provat materiale”

1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes,gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materialeduke urdhëruar:

- a) sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajoose shpërblimin e dhënë a të premtuar për kryerjen e saj, merren dhei kalojnë shtetit, përveç rastit kur këto sende janë të personave që nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale;
 - b) sendet, mbajtja ose qarkullimi i të cilave është i ndaluar, udorëzohen enteve përkatëse ose zhduken;
 - c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken;
 - ç) sendet e tjera u kthehen personave që u takojnë dhe, kur kakonflikt për pronësinë e tyre, ruhen gjersa ai të zgjidhet nga gjykata.
2. Provat materiale mund t'u kthehen personave që u përkasinedhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes

Sipas nenit 218 të K.Pr.Penale rezulton se:”Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara”

1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.
2. Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata.
3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankim në gjykatë.

Nga sa më sipër Gjykata, mbasi tërhoqi nga arkiva penale si dhe administroi edhe dosjen gjyqesore që i përket vendimit Nr. 2799 Vendimi, datë 25.10.2018, të Gjyqates së Rrethit Gjyqesor Tirane, ku ndodhen edhe dokumentat e sekuestruara, si dhe mbasi mori edhe mendimin e prokurores e cila u shpreh per pranimin e kerkeses, çmon se kërkesa është e bazuar ne ligj dhe ne prova dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenen 190,218, 470,480 të K.Pr.Penale:

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Kthimin e dokumentave të sekuestruara me procesverbal datë 16.05.2016 për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të datës 23.03.2016 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave.
- Shpenzimet procedurale i ngarkohen kërkuessit.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palet brenda 15 (pesëmbëdhjete) diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes se këtij vendimi.

-U shpall sot në Tirane më datë 16.07.2020 .

SEKRETARE
ORNELA BALLA

GJYQTARI
ARTAN GJERMËNI

Shpenzime gjyqesore nuk ka!